



**SHOQATA KOMBËTARE E GJYQTARËVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Tiranë, më 16.01.2026

PRAPËSIMË

Përpara Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Të nderuar zotërinj gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese!

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me një kërkesë me palë dhe objekt si më poshtë:

KËRKUES: Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar si person juridik në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin Nr. 2160, datë 25.01.2008, me seli qendrore në Tiranë, me adresë elektronike njoftimi: engertp82@gmail.com, me Nr. Cel +355693301470, e përfaqësuar nga Kryetari i saj, Z. Engert Pëllumbi, gjyqtar pranë Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

OBJEKTI: Ndërhyrja si subjekt i interesuar në procesin gjyqësor kushtetues me kërkesë Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, subjekte të interesuara Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe me objekt – *“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1 dhe 2 të ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” që parashikojnë: 1- “a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës” dhe 2- “2. Për vitin 2023 paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë përllogaritet sipas këtij ligji nga data 1 prill duke u bazuar, për efekt të përllogaritjes, në pagën e Presidentit të Republikës me vlerë 425.000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë”.*

BAZA LIGJORE: Neni 39, pika 1, shkronja “b”, e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, dhe neni 26, pika 2, e Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

Referuar shkresës suaj me Nr. 3 (U) Regj. Them., datë 21.11.2025, jemi bërë me dije se Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, në datën 20.11.2025, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën, ka vendosur pranimin e saj dhe thirrjen tonë si subjekt i interesuar në çështjen me kërkesë Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, subjekte të interesuara Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor si dhe me objekt: *“Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të nenit 1 dhe 2 të ligjit nr. 33/2023 “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”” që parashikojnë: 1- “a) paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës” dhe 2- “2. Për vitin 2023 paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë përllogaritet sipas këtij ligji nga data 1 prill duke u bazuar, për efekt të përllogaritjes, në pagën e Presidentit të Republikës me vlerë 425.000 (katërqind e njëzet e pesë mijë) lekë”*. Gjithashtu, në të njëjtën shkresë bëhej me dije se duhet të vinim në dispozicion, brenda datës 02.12.2025 parashtrimet me shkrim për kërkesën e paraqitur si dhe çdo dokument tjetër, të cilat duhet të jenë një kopje për gjykatën dhe nga një kopje për secilën palë pjesëmarrëse në gjykim, detyrim të cilin rezulton se e kemi përmbushur.

Më tej, rezulton se me shkresën tuaj Nr. 3 (U) Regj. Them., datë 09.01.2026, na keni vënë në dispozicion kërkesën e parashtruar nga ana e Këshillit të Ministrave, me objekt revokimin e vendimit të mbledhjes së gjyqtarëve të datës 20.11.2025, për thirrjen e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë si subjekt i interesuar ose, në alternativë, pezullimin e gjykimit të çështjes. Në bërjen e kësaj kërkesë, subjekti i interesuar në këtë gjykim kushtetues, Këshilli i Ministrave, mbështetet në pikën 5, të nenit 50 (regjimi tranzitor) të Ligjit Nr. 80/2021 *“Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”*, i ndryshuar. Në themel të kërimit të saj, Këshilli i Ministrave parashtron faktin se Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë nuk rezulton të jetë regjistruar në administratën tatimore brenda afatit prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh nga hyrja në fuqi e ligjit Nr. 80/2021 *“Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”*. Si rrjedhojë, Këshilli i Ministrave pretendon se Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë e ka humbur subjektivitetin e saj juridik dhe për rrjedhojë legjitimitimin për të qenë palë në këtë gjykim kushtetues. E konsiderojmë haptazi të pabazuar këtë qëndrim të Këshillit të Ministrave për argumentet që do të parashtrujmë më poshtë.

Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë është themeluar në vitin 2008. Duke pasur parasysh se, prej disa vitesh, organet e kësaj Shoqate nuk ishin rizgjedhur dhe se ajo nuk kishte pasur aktivitet, mbajtur në konsideratë këtu edhe periudhën e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në datën 31.10.2025, anëtarësia e Shoqatës ka arritur të realizojë mbledhjen e Asamblesë për rikonstituimin e këtyre organeve. Nga kjo mbledhje u arrit të zgjidhej Kryetari i Shoqatës, Nënkryetari, Sekretari dhe anëtarët e Këshillit të saj Drejtues. Rezulton se këto vendime janë përcjellë bashkë me kërkesën respektive për regjistrim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe më tej janë miratuar nga kjo gjykatë, duke u pasqyruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse.

Me shkresën Nr. 22087 Prot., datë 12.12.2025, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, kemi marrë dijeni rishtazi se Shoqata Kombëtare e Gjuqtarëve të Republikës së Shqipërisë nuk ishte e regjistruar në organet tatimore, sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar. Pas njohjes me këtë shkresë, Kryetari i Shoqatës ka vënë në dijeni menjëherë Këshillin Drejtues dhe anëtarësinë e saj, duke vijuar me marrjen e masave për plotësimin e këtij detyrimi ligjor. Konkretisht, në datën 22.12.2025 Shoqata ka realizuar Kontratën e Huapërdorjes me shtetasen Elza Balla. Objekt i kësaj kontrate është dhënia përkohësisht me huapërdorje dhe pa kundërshtim e apartamentit me sipërfaqe 60 m², të ndodhur në Tiranë, Rruga “Islam Alla”, Pallati “Alba Flor”, nr. 17, Kati II. Qëllimi i realizimit të kësaj kontrate ka qenë dhe mbetet përcaktimi i selisë së re të Shoqatës Kombëtare të Gjuqtarëve të Republikës së Shqipërisë, në mënyrë që të mundësohet plotësimi i kushteve të parashikuara nga Ligji Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, për të kryer regjistrimin e Shoqatës në organet tatimore. Kontrata ka parashikuar se hyn në fuqi në datën 01.01.2026. Në vijim, në datën 26.12.2025, është zhvilluar mbledhja e Asamblesë së Anëtarëve të Shoqatës dhe është miratuar selia sipas kontratës së sipërcituar të huapërdorjes. Më pas, në datën 29.12.2025 Shoqata ka paraqitur kërkesën përkatëse në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për regjistrimin e vendimit të Asamblesë së Anëtarëve për përcaktimin e selisë, çka është pranuar me vendimin nr. 2160/5, datë 12.01.2025, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për këtë fakt është vënë në dijeni edhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me shkresën e datës 15.01.2026.

Rezulton se me shkresën Nr. 22687/1 prot., datë 13.01.2026, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë i ka kërkuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë çregjistrimin e Shoqatës Kombëtare të Gjuqtarëve të Republikës së Shqipërisë nga regjistri i organizatave jofitimprurëse, mbi bazën e pikës 5, të nenit 50 të Ligjit Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, duke qenë se nga hyrja në fuqi e këtij ligji ka kaluar afati një vjeçar dhe kjo Shoqatë nuk është regjistruar në organet tatimore. Pikërisht, mbështetur në këtë shkresë të fundit të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, Këshilli i Ministrave ka kërkuar nga Gjykata Kushtetuese revokimin e vendimit të mbledhjes së gjuqtarëve të datës 20.11.2025, për thirrjen e Shoqatës Kombëtare të Gjuqtarëve të Republikës së Shqipërisë si subjekt i interesuar ose, në alternativë, pezullimin e gjyqimit të çështjes. Kërkesa e Këshillit të Ministrave rezulton se nuk mban në konsideratë një sërë parimesh dhe institutesh procedurale civile.

Së pari, legjitimitimi i një subjekti procedural, në kuptimin e personalitetit të tij juridik dhe interesit të ligjshëm, vlerësohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për të investuar një juridiksion të caktuar (administrativ, gjyqësor ose kushtetues) ose për tu bërë pjesë e një procesi tashmë të nisur dhe prezumohet i tillë gjatë të gjithë procesit në fjalë, deri sa të provohet e kundërta. Shoqata Kombëtare e Gjuqtarëve të Republikës së Shqipërisë e ka fituar personalitetin e saj juridik me regjistrimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Referuar bazës ligjore të cituar nga Këshilli i Ministrave, pikës 5, të nenit 50 të Ligjit Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, për çregjistrimin e një organizate jofitimprurëse kërkohet domosdoshmërisht një vendim nga ana

e gjykatës dhe nuk përbën një fakt i cili mund të konstatohet kryesisht nga kushdo. Përfshirja e gjykatës në këtë procedurë nuk është formale por substanciale pasi është vetëm gjykata ajo që do të konkullojë nëse janë përmbushur ose jo kushtet që organizata jofitimprurëse, në këtë rast shoqata, të çregjistrohet. Jo pa qëllim ligjvënësi, në nenin 31 të Ligjit Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, ka përfshirë gjykatën në procesin e regjistrimit dhe çregjistrimit të një organizate jofitimprurëse, duke qenë se bëhet fjalë për një liri themelore më natyrë kushtetuese, sikurse është e liria e organizimit kolektiv, e sanksionuar nga neni 46 i Kushtetutës dhe neni 11 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Lidhur me këtë, deri në këtë moment, nuk rezulton që të ketë ndonjë vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për çregjistrimin e Shoqatës Kombëtare të Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë ose të ketë filluar ndonjë proces gjyqësor për këtë qëllim.

Së dyti, sikurse u theksua më sipër, pas rifillimit të veprimtarisë, Shoqata i ka ndërmarrë të gjitha hapat për të bërë të mundur regjistrimin e saj në administratën tatimore dhe është në fazën e ndjekjes së këtyre procedurave, pasi e ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Mosregjistrimi i Shoqatës deri në këto momente nuk ka ardhur për shkak të mungesës së vullnetit të saj por si pasojë e inaktivitetit të veprimtarisë si rrjedhojë e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Siç përmendëm më sipër, Shoqata e ka rifilluar aktivitetin në datën 31.10.2025, me ripërtëritjen e organeve drejtuese. Në këto rrethana, në se do të jetë e nevojshme, Shoqata do të kërkojë rivendosje në afat të së drejtës për të kërkuar regjistrimin pranë organeve tatimore si dhe do të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe gjyqësore për të detyruar administratën në fjalë që ta regjistrojë atë, në rast refuzimi.

Së treti, në nenin 52 të Kodit Civil parashikohen rastet e shpërndarjes së shoqatave, ndër të cilët, në shkronjën “d”, ka një rezervë ligjore. Në hierarkinë e burimeve të së drejtës ligjet vijnë pas Kushtetutës dhe marrëveshjeve ndërkombëtare dhe janë norma referuese për vlefshmërinë e akteve normative të nxjerra nga institucionet qendrore të administratës publike. Edhe brenda kategorisë së ligjeve ekziston dallimi duke u nisur nga procedura e miratimit të tyre. Kushtetuta në nenin 81, paragrafi II, ka renditur ligjet, për miratimin e të cilëve kërkohet shumica e tre të pestave të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Ndër to bëjnë pjesë dhe Kodet.

Rëndësia e disa prej marrëdhënieve juridike ka bërë që ligjvënësi rregullimin e tyre të mos t’ia lërë në dorë çdo shumice të përkohshme parlamentare por të ekzistojë një konsensus më i gjerë ndërmjet anëtarëve të trupës legjislativë. Një zgjedhje e tillë vjen edhe nga fakti se Kodet nuk janë ligje me natyrë të pastër politike, por kryesisht të natyrës teknike, që shërbejnë për garantimin dhe realizimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit. Për sa kohë një marrëdhënie ose grup marrëdhëniesh juridike gjejnë rregullim me një ligj me shumicë të cilësuar, çdo amendim (shtesë, ndryshim, shfuqizim) që lidhet me këtë fushë duhet të bëhet me të njëjtën shumicë. Mosrespektimi i këtij kriteri formal do të çonte në pasoja antikushtetutshmërie pasi do të cenohet parimi i sigurisë juridike.

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese ka vënë në dukje se: “... Kushtetuta u jep ligjeve të përforcuara fuqi të veçantë juridike në krahasim me aktet e zakonshme të ligjvënësit. Për këtë arsye, në hierarkinë e akteve, ligjet e përforcuara renditen para ligjeve të zakonshme të Kuvendit. Gjykata çmon se Kuvendi nuk mund të miratojë një ligj të ri ose shtesa në një ligj të mëparshëm, të cilat kërkojnë “shumicë të cilësuar”, me “shumicë të thjeshtë”, sepse në këtë

mënyrë ligjet që kërkojnë “shumicë të cilësuar” mund ta humbasin rëndësinë e tyre (**shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 19/2007, nr. 9/2010 dhe nr. 23/2011**). Gjykata, në çështjen në shqyrtim, e sheh me vend të nënvizojë dallimin që ekziston midis ligjeve organike, që miratohen me shumicë të cilësuar, dhe ligjeve të zakonshme që miratohen me shumicë të thjeshtë. Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës ligjet organike ose të cilësuar, qëndrojnë më lart se ligjet e zakonshme. Nga kjo pikëpamje ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nëse kushtetutëbërësi do të kishte dëshiruar një trajtim të njëjtë të tyre, neni 81, pika 2, i Kushtetutës nuk do të ekzistonte. Nga shqyrtimi i debateve të Komisionit Parlamentar për hartimin e Kushtetutës rezulton se ekzistonte ideja që një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë të tyre, të miratoheshin nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, së pari për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike, që do të kishte shumicën, të cënonte parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike (**Shih “Debati Kushtetues 1” fq. 298 e në vijim**). Gjykata çmon se delegimi që ka bërë ligjvënësi në paragrafin e dytë të nenin 1, shkronja a, të Kodit Penal për përfshirjen e dispozitave penale edhe në ligje të tjera, nuk është argument për të justifikuar miratimin e dispozitave të reja penale me ligje të thjeshta (siç quhen në doktrinën kushtetuese ligjet që kërkojnë miratim me shumicë të thjeshtë). Një delegim i tillë duhet të respektojë në çdo rast parimet e ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenet 4, 29, në lidhje dhe me nenin 81, pika 2, të Kushtetutës (**shih vendimin nr. 1/2011 të Gjykatës Kushtetuese**).”

Në të njëjtën linjë arsyetimi me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese ndodhemi edhe në çështjen në shqyrtim, ku rregullimi i marrëdhënieve juridike lidhur me statusin e shoqatave, është bërë nëpërmjet një ligji të përforcuar. Siç u theksua më lart, krijimi dhe shpërndarja e një shoqate lidhet me lirinë e organizimit kolektiv, e sanksionuar nga neni 46 i Kushtetutës dhe neni 11 i KEDNJ-së. Jo pa shkak, ligjvënësi i ka renditur në nenin 52 të Kodit Civil rastet e shpërndarjes së shoqatave, me pasojë përfundimin e personalitetit të tyre juridik dhe vetëm shkronjën “d” e ka lënë të hapur për të referuar në ligje të tjera. Për këtë arsye, përcaktimi i një rasti për shpërndarjen e shoqatës dhe çregjistrimin e saj që nuk parashikohet në nenin 52 të Kodit Civil, mund të bëhet vetëm përmes një ligji të miratuar me të njëjtën shumicë pasi në këtë rast jemi përpara rezervës ligjore të përforcuar. Në këtë kuadër, pika 5, e nenit 50 të Ligjit Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, është një dispozitë antikueshtetuese pasi vjen në kundërshtim me nenin 81, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dispozitë që normon procedurën dhe shumicën e kërkuar për miratimin e një ligji.

Së katërti, procedura e shqyrtimit të kërkesës për çregjistrimin e personave juridikë, duke qenë një gjykim gracioz, sanksionohet jo vetëm nga neni 31 i Ligjit Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, por edhe nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë këtë procedurë gjykimi, konkretisht nenet 388 – 392 të këtij Kodi, nën titullin “Vërtetimi Gjyqësor i Fakteve”. Pikërisht, në nenin 392 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuarit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t'i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme.” Për sa më sipër, në momentin që Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë do marrë dijëni lidhur me ndonjë proces

gjqësor të mundshëm me objekt çregjistrimin e saj, do të ndërhyrë me cilësinë e personit të tretë për ta kundërshtuar kërkesën në fjalë dhe, për pasojë, gjykata do të jetë e detyruar të pushojë shqyrtimin e çështjes në fjalë, duke i orientuar palët që t'i drejtohen asaj me padi.

Së pesti, është e rëndësishme të theksohet se e gjithë procedura e ndjekur prej datës 30.10.2025 e deri më tani tregon vullnetin e paekuivokë të organeve të rikrijuara të Shoqatës Kombëtare të Gjqytarëve të Republikës së Shqipërisë për të përmbushur kriteret ligjore dhe paraqitur kërkesë pranë organeve tatimore për regjistrim, por kjo pavarësisht dëshirës së Shoqatës kërkon kohë për kryerjen e veprimeve procedurale përkatëse.

Ligji Nr. 80/2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, i ndryshuar, në nenin 50 pika 5 ka parashikuar se: “Organizatave jofitimprurëse, që nuk janë të regjistruara në administratën tatimore, si dhe nuk kërkojnë regjistrimin në administratën tatimore brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çregjistrohen nga regjistri i organizatave jofitimprurëse.” Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 17 gusht 2021. Vlerësojmë se neni 50, pika 5, i ligjit të sipërcituar, nëse zbatohet në mënyrë literale, ashtu siç është shkruar, paraqet problematika thelbësore lidhur me kushtetutshmërinë e tij. Për pasojë, kjo dispozitë duhet të interpretohet në përputhje me nenet 15, 17, 46 dhe 48 të Kushtetutës, si dhe me nenin 11 të KEDNJ-së. Kjo nënkupton se afati i përcaktuar në këtë ligj për shoqatat tashmë të krijuara dhe të pajisura me personalitet juridik, për t’u regjistruar në organet tatimore, duhet kuptuar si një afat disiplinues, i cili në asnjë rast nuk mund të sjellë shuarjen *ipso iure* të Shoqatës.

Një rregullim i tillë ligjor, në raste analoge është konsideruar nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut si i papajtueshëm me parimin e proporcionalitetit në kufizimin e lirisë së organizimit, të garantuar nga neni 11 i KEDNJ-së. Dispozitat që kufizojnë liritë themelore në mënyrë të përgjithshme dhe automatike, pa një vlerësim gjyqësor individual, përbëjnë parashikime ligjore të legjislacioneve kombëtare që bien në kundërshtim me Konventën (*shih, ndër të tjera, çështjen Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar*). Një ndëshkim i tillë është joproportional në raport me qëllimin që synon të justifikojë, konkretisht regjistrimin në organet tatimore. Qëllimi i këtij parashikimi ligjor është garantimi i kontrollit mbi veprimtarinë ekonomike të organizatave jofitimprurëse, të cilat, në vetvete, ndjekin qëllime jofitimprurëse.

Në këtë kuptim, në rastin konkret, Shoqata nuk ka kryer asnjë aktivitet që prej vitit 2016, siç është përmendur më sipër dhe as që mund të bëhet fjalë për aktivitet ekonomik të saj. Mosrespektimi i këtij detyrimi, i cili ka ndodhur për shkaqe objektive, nuk ka sjellë asnjë pasojë që do të përlligjte ndërhyrjen me një masë kaq ekstreme ligjore, e cila çon në atë që doktrinarisht quhet “vdekja e personit juridik”, pasi i hiqet zotësia juridike. Kjo dispozitë parashikon një ndëshkim ekuivalent me dënimin penal për personat juridikë dhe, për pasojë, cenon në mënyrë joproportionale lirinë e organizimit dhe veprimtarisë së OJF-ve, në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 11 të KEDNJ-së.

Së gjashti, çmojmë se nuk jemi në kushtet e pezullimit të këtij gjykimi kushtetues, në kuptim të nenit 297, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile. Është e vërtetë se pika 2, e nenit 1, të Ligjit Nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: “Për çështje që lidhen me procedura që nuk rregullohen nga ky ligj apo nga Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese merr parasysh edhe dispozitat ligjore që rregullojnë procedurat e tjera, duke marrë në konsideratë natyrën ligjore të çështjes”, por në këtë rast, pezullimi i gjykimit

është një institut që rregullohet nga vetë ky ligj. Në nenin 44/b, të Ligjit Nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me nenin 38 të Ligjit Nr. 99/2016, disiplinohet pezullimi i gjykimit kushtetues. Kjo dispozitë parashikon se: “1. Nëse Gjykata Kushtetuese, gjatë shqyrtimit të çështjes, vendos të kërkojë një opinion këshillimor nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, lidhur me zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe protokolleve shtesë të saj ose të kërkojë *amicus curia* nga organizma të tjerë, ajo vendos pezullimin e shqyrtimit të çështjes. 2. Seanca rihapet menjëherë pas marrjes së opinionit këshillimor nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ose *amicus curia*. Opinioni i marrë u njoftohet palëve bashkë me datën e seancës.” Pra, e vetmja situatë kur mund të pezullohet gjykimi kushtetues është rasti kur Gjykata Kushtetuese i drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ose një organizmi tjetër ndërkombëtar me kërkesë *amicus curia*. Për rrjedhojë, në këtë rast, nuk gjejnë zbatim parashikimet e pezullimit të gjykimit që përcaktohen nga Kodi i Procedurës Civile, duke qenë se instituti rregullohet nga ligji i posaçëm. Kjo është më se arsyeshme sepse nuk mund të pezullohet gjykimi kushtetues për shkak të një procesi gjyqësor të zakonshëm, i cili mund të zgjasë shumë në kohë. Një qëndrim i tillë do të shkaktohte mohimin e aksesit në gjykimin kushtetues. Krejt e kundërta është e vërtetë, rasti kur gjykata e zakonshme pezullon gjykimin për shkak të dërgimit të ligjit ose dispozitës ligjore në Gjykatën Kushtetuese për ta shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën, referuar nenit 145, pika 2, të saj.

Po në këtë kuadër, theksojmë se ky gjykim kushtetues është iniciuar nga Unioni i Gjiqtarëve të Shqipërisë dhe se Shoqata Kombëtare e Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë ka hyrë në të si subjekt i interesuar. Pra, fati i gjykimit kushtetues në këtë rast nuk varet nga vijimi i gëzimit të personalitetit juridik të Shoqatës dhe për pasojë vijimi i legjitimitetit të saj. Për më tepër që në këtë rast bëhet fjalë për një gjykim abstrakt, i cili nuk lidhet ngushtësisht me interesat e Unionit të Gjiqtarëve apo Shoqatës Kombëtare të Gjiqtarëve, por prek të gjithë komunitetin e magistratëve si dhe të funksionarëve pagat e të cilëve referojnë në pagat e këtij komuniteti.

Për sa u parashtrua më sipër, i kërkojmë Gjykatës Kushtetuese rrëzimin e kërkesës së subjektit të interesuar Këshilli i Ministrave, me objekt revokimin e vendimit të mbledhjes së gjiqtarëve të datës 20.11.2025, për thirrjen e Shoqatës Kombëtare të Gjiqtarëve të Republikës së Shqipërisë si subjekt i interesuar ose, në alternativë, pezullimin e gjykimit të çështjes.

Bashkëlidhur: Vendimi Nr. 2160/5, datë 15.01.2026, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; Vërtetim nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve; Shkresa e datës 15.01.2026, me lënë informacion, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

PËR SHOQATËN KOMBËTARE TË GJIQTARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**KRYETARI
ENGERT PËLLUMBI**